

AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"CHICKEN HOUSE" SH.P.K

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar, sot më datë 31.12.2019, anëtarët e mëposhtëm:

- **Shoqëria "Chicken Farm Albania" sh.p.k**, person juridik shqiptar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit më datë 31.10.2013, me NIPT- L33431801N, në cilësinë e ortakut zotërues të 50 % (pespesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë, përfaqësuar nga administrator i saj **Z. Marenglen Meqemeja**, shtetas shqiptar, lindur më 10.07.1978, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. Personal: H807100750, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

-**Z. Arbër Sali**, shtetas shqiptar, lindur më 26.02.1986, në Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. Personal: I60226066K, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e ortakut zotërues të 25 % (njëzetë e pesë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë;

dhe

-**Z. Gëzim Pani**, shtetas shqiptar, lindur më 22.08.1978, në Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. Personal: H80822036L, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e ortakut zotërues të 25 % (njëzetë e pesë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ka vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit të mëposhtëm, për krijimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga Legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj.

NENI 1
EMËRTIMI I SHOQËRISË



- 1.1 Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "CHICKEN HOUSE" SH.P.K., në vijim referuar si "Shoqëria".

NENI 2 BAZA LIGJORE

- 2.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 2.2 Kjo Shoqëri fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 3 SELIA

- 3.1 Selia kryesore e aktivitetit të Shoqërisë është në adresën: Rruga e Elbasanit, Vila Nr.71, Njësia Administrative Nr. 2, Tiranë.
- 3.2 Shoqëria mund të hapë filiale, degë përfaqësie ose agjensi në varësi të saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në çdo kohë që çmohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

NENI 4 OBJEKTI

- 4.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë përfshin sa më poshtë vijon:

-Krijimi dhe menaxhimi i impianteve të rritjes, përpunimit, therjes dhe tregëtimit të pulave dhe mishit të pulës apo i të gjitha kafshëve, mishi i të cilave tregëtohet në tregun vendas dhe të huaj. Zhvillimi i teknologjive të reja në fushën e rritjes, përpunimit, therjes dhe tregëtimit, si dhe import-eksporti i pulave të gjalla dhe mishit të të gjitha kafshëve, kryesisht pulave, mishi i të cilave tregëtohet në tregun vendas dhe të huaj;

- Prodhim, Import-Eksport i nënprodukteve të mishit të të gjitha llojeve të kafshëve;

-Import - Eksport i produkteve me të cilat ushqehen kafshët, si dhe makinerive dhe mjeteve që shërbejnë për impiantet e rritjes, përpunimit, therjes dhe tregëtimit dhe makinerive që shërbejnë për prodhimin e nënprodukteve të mishit të pulave, si dhe mishit të të gjitha kafshëve që tregëtohet në tregun vendas e të huaj;

-Furnizimi dhe tregëtimi në pikat e konsumit dhe tregje e vendit të të gjithë produkteve që përmenden në objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

-Furnizimi dhe tregëtimi në pikat e konsumit dhe tregje e vendit të të gjithë produkteve që përmenden në objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

-Importimi i disinfektantëve ushqimorë, vaksinave të ndryshme të shpendëve dhe kafshëve, si dhe të gjitha produkteve të tjera medicinale të nevojshme për zhvillimin e aktivitetit të saj primar, rritjes së shpendëve.

NENI 5 KOHËZGJATJA

5.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë është me afat të pacaktuar.

NENI 6 KAPITALI THEMELTAR

6.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 10.000 (dhjetë mijë) Lekë, tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga Ortakët e Shoqërisë.

6.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 3 (tre) kuota.

6.3 Pjesët e kapitalit zotërohen nga Ortakët e Shoqërisë si më poshtë:

-Shoqëria "Chicken Farm Albania" sh.p.k zotëron 1 (një) kuotë, e cila përfaqëson 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

-Z. Arbër Saliaj zotëron 1 (një) kuotë, e cila përfaqëson 25% (njëzetë e pesë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

- Z. Gëzim Pani zotëron 1 (një) kuotë, e cila përfaqëson 25% (njëzetë e pesë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

NENI 7 TRANSFERIMI I Pjesëve të Kapitalit Themeltar

7.1 Pjesët e kapitalit themeltar janë të transferueshme ndaj të tretëve sipas procedurave të parashikuara në Statutin e shoqërisë dhe në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

NENI 8 ADMINISTRIMI



- 8.1** Emërohet Administrator i *Shoqërisë Z. Andri Ibrahimaj*, shtetas shqiptar, lindur më 20.05.1976, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i Kartës së Idenitetit me Nr. Personal: H60520073R, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- 8.2** Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.
- 8.3** Administratori është i autorizuar të veprojë në emër të *Shoqërisë* në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit si dhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.
- 8.4** Administratori do të qëndrojë në detyrë për 5 (pesë) vjet dhe gëzon të drejtën e riemërimit në këtë detyrë pas përfundimit të mandatit të tij.

NENI 9 DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

- 9.1** Çështjet që nuk trajtohen në këtë Akt Themelimi, rregullohen në Statutin e *Shoqërisë* si dhe në legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 9.2** Ky Akt Themelimi është hartuar në Tiranë, Shqipëri në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe, duke patur të gjitha të njëjtën fuqi ligjore.

ORTAKËT E SHOQËRISË:

Shoqëria "Chicken Farm Albania" sh.p.k

Përfaqësuar nga Administratori i saj

Marenglen Meqemeja

Arbër Saliaj

Arber Saliaj


Gëzim Pani

Gëzim Pani


